



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan,
Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

DORACAK PËR STUDENTIN



Të nderuar lexues të doracakut të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan,

Duke ndarë kohën tuaj të çmueshme për Universitetin tonë, do të kuptoni besimin dhe shpresat e studentëve, profesorëve, asistentëve dhe të administratës së UKZ për të krijuar një universitet të ri, modern, cilësor dhe të pajtueshëm me tregun e punës.

Ne jemi universitet i ri, por kjo na ofron mundësinë që universitetin tonë ta orientojmë drejt qëllimeve të reja, me strategji e metoda të reja, në mënyrë që studenti i UKZ, me diplomën e tij, të jetë i barabartë me studentët e tjerë në vend, në rajon dhe në hapësirën evropiane.

Universiteti është një mundësi e madhe për shoqërinë, me kusht që aty të kultivohet mendja e hapur e studentëve, të kultivohet mendimi kritik dhe të nxitet hulumtimi shkencor. Vetëm me këtë qasje studentët tanë mund t’ia kthejnë borxhin shoqërisë, atdheut dhe mbarë botës: përmirësimin e mirëqenies sociale, zhvillimin ekonomik si dhe promovimin e garës duke respektuar konkurrencën. Vetëm me këtë qasje Universiteti ynë mund ta luajë rolin e dritares dhe të portës së shoqërisë: një dritare e hapur për të parë më shumë dhe një portë e hapur për të komunikuar më shumë dhe të barabartë me botën. Vetë fjala universitet e ka këtë kuptim.

Shoqëria jonë, sikur shoqëritë tjera në tranzicion, vuan nga shpërputhja midis mësimave akademike që ofrojnë universitetet dhe kërkesave të tregut të punës për universitetet. Ne synojmë që UKZ ta bëjmë kompatibil me tregun e punës, duke pasur parasysh resurset kosovare dhe kërkesat e tregut global.

Kosova një ditë gjithsesi do të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. Me të hyrë në tregun evropian, studenti i UKZ e ka në konkurrencë studentin evropian, si për vendin e punës, si për hulumtime shkencore dhe për çdo aspekt tjetër akademik. Mënyra e vetme për ta përballuar këtë konkurrencë është ngritja e cilësisë së mësimin në Universitet dhe hapja e mundësive për hulumtime.

Universiteti ynë e sheh si çështje parësore bashkëpunimin me hisedarët e arsimit akademik, duke nisur që nga institucionet profesionale, grupet shoqërore e deri edhe te shoqëria civile. Vetëm mbi një komunikim të rregullt për kërkesat e shoqërisë dhe mundësitë e saja në mund të projektojmë programet tona studimore.

Universiteti ynë e sheh si çështje shumë të rëndësishme edhe bashkëpunimin me universitetet e tjera, vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Mobiliteti i studentëve është shumë i frytshëm jo vetëm për studentët por edhe për vetë UKZ. Komunikimi i traditave, i kulturave, i ideve, i hulumtimeve dhe i prirjeve të tjera akademike është në frymën dhe në shpirtin e Universitetit tanë.

Universiteti ynë e sheh si begati strukturën multi-kulturore të shoqërisë sonë, si dhe multikulturalizmin e shoqërive përreth Republikës së Kosovës. Prandaj, ne e shohim të rëndësishëm bashkëpunimin me të gjitha këto struktura sociale dhe orientimin e programeve studimore në këto kahe.

Për të arritë këto qëllime, UKZ duhet të krijojë dhe ta ketë gjithnjë një staf akademik të aftë dhe një administratë efektive.

Ne jemi të hapur dhe kërkues për secilin person akademik, i cili mund të sjellë risi në UKZ, në cilëndo fushë akademike dhe në cilindo aspekt akademik.

Ne po synojmë një universitet të ri-për një shoqëri të re. Na priftë e mbara të gjithëve!

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

VIZIONI DHE MISIONI I UNIVERSITETIT

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan i themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës më datë 6 mars 2013, është ndër universitetet e reja të Kosovës për promovimin e kërkimit akademik dhe shkencor.

UKZ ka një rol dhe përgjegjësi të veçantë në avancimin dhe zhvillimin e pasurisë intelektuale, shkencore, artistike dhe kulturore të:

Rajonit të Gjilanit (komunat: Gjilan, Kamenicë, Novo Berdë, Ranillug, Viti, Partesh, Klllokot, Ferizaj, Kaçanik, Elez Han, Shtime)

Rajoni i Preshevës: Komuna e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës.

Rajoni i Kumanovës (Maqedonia e Veriut): Kumanova, Likova.

Vizioni i Universitetit "Kadri Zeka " në Gjilan është krijuar për t'i shërbyer dijes, arsimit dhe mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe më gjerë."

Misioni i UKZ është përshtatur me tre shtyllat kryesore: mësimdhënie, hulumtim dhe shërbim në komunitet.

UKZ është tempull i dijes, i cili kultivon dashurinë njerëzore dhe afirmon parimet e konkurrencës lojale; përgatitë të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie moderne dhe globale, pjesë e një tregu më të gjerë sesa tregjet tradicionale të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë sonë; nxitë mendimin kritik dhe shpirtin e ndërmarrësisë.

Ky mision është i mbështetur në disa shtylla: mësimi dhe dija; shoqëria moderne dhe konkurrenca lojale; tregjet moderne të punës; mendimi kritik, hulumtues dhe ndërmarrës.



AKREDITIMI DHE RIAKREDITIMI PËR STUDIMET BACHELOR DHE MASTER

Programet e studimit Bachelor dhe akreditimi

Fakulteti	Programi	Akredituar	Deri	Riakredituar	Deri
Edukimi	Arsimi Parashkollor	01.10.2014	30.09.2016	01.10.2016	Në Proces
	Arsimi Fillor	01.10.2014	30.09.2016	01.10.2016	Në Proces
Ekonomik	BFK	01.10.2014	30.09.2017	01.10. 2017	30.09.2021
	Menaxhment	01.10.2014	30.09.2016	01.10. 2016	Në Proces
	Marketing	01.10.2014	30.09.2017	01.10. 2017	30.09.2021
Juridik	Juridik i Përgjithshëm	01.10.2014	30.09.2016	01.10.2016	Në Proces
	Juridiko				
Shkenca	Shkenca	01.10.2014	30.09.2016	01.10.2016	Në Proces
Kompjuterike	Kompjuterike				
	Sistemet dhe Teknologjia e				Në proces
	Kontrollit				
Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	1.10.2019	30.09.2022		

PROGRAMET E STUDIMIT MASTER DHE AKREDITIMI

Programet e studimit master dhe akreditimi

Universitetet /Fakultetet	Programi	Akredituar	Deri	
1. Universiteti Publik "Kadri Zeka", Gjilan, Fakulteti Juridik 2. Universiteti "Ukshin Hoti", Prizren, Fakulteti Juridik 3. Universiteti "Haxhi Zeka", Pejë, Fakulteti Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	01.10.2017	30.09.2021	
Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan 1. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike 2. Fakulteti Juridik, 3. Fakulteti Ekonomik	E - Qeverisja	01.10.2017	30.09.2021	
Fakulteti i Edukimit	✓ Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe ✓ Mësimdhënie dhe kurrikula	Në Proces		
Fakulteti Juridik	✓ Juridiko Penal	Në Proces		
Fakulteti Ekonomik	✓ Menaxhim dhe ndërmarrësi ✓ Menaxhim financiar ✓ Menaxhim i Marketingut dhe Komunikimit	Në Proces		
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe Inteligenca Artificiale			
Akreditimi institucional	Akredituar	Deri	Ri akredituar	Deri
1. Universiteti Publik "Kadri Zeka", Gjilan,	01.10.2014	30.09.2017	01.10.2017	30.09.2021

STUDENTËT E UKZ-SË NDËR VITE

Niveli	Fakulteti	Programi	13/14	14/15	15/16	16/17	17/18	18/19	19/20	Gjithsejtë
Bachelor	Edukim	Fillor	114	64	108	144	126	121	105	782
Bachelor	Edukim	Parafillor	113	66	75	78	78	77	47	534
Bachelor	Juridik	Juridik i pergjithshem	372	304	258	270	255	233	217	1909
Bachelor	Ekonomik	Banka, financa dhe Kontabilitet	188	202	177	145	80	85	123	1000
Bachelor	Ekonomik	Menaxhment dhe Informatike	152	154	137					443
Bachelor	Ekonomik	Marketing	100	110	66	64	64	79		483
Bachelor	Ekonomik	Menaxhment				117	93	101	125	436
Bachelor	Shkenca Kompjuterike	Shkenca Kompjuterike		54	60	101	95	76	64	450
Bachelor	Shkenca Aplikative	Matematike Arsimore							22	22
Master	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqeria Demokratike					51	28	22	101
Master	Shkenca Kompjuterike, ekonomik dhe Juridik	E-Qeverisja					60	45	37	142
Gjithsejt			1039	954	881	919	902	845	762	6302

NUMRI I STUDENTËVE TË DIPLOMUAR NË NIVELIN BAÇELOR

Fakulteti	Numri i studentëve të diplomuar
Edukim	338
Juridik	208
Ekonomik	421
Shkenca Kompjuterike	94
Matematikë Arsimore	0




STAFI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Profesorë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	36
Asistentë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	8
Ligjërues në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	3
Profesorë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	6
Asistentë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	45
Administratë	31
Gjithsej	125

BUXHETI I UKZ-SË NDËR VITE

Programi	Vitet	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Totali
Universiteti "Kadri Zeka"	2014	866,667.00	370,778.00	62,556.00	10,000.00	200,000.00	1,510,001.00
Universiteti "Kadri Zeka"	2015	1,044,413.00	349,161.00	50,000.00	10,000.00	370,000.00	1,823,574.00
Universiteti "Kadri Zeka"	2016	746,895.00	316,339.00	50,000.00	10,000.00	320,000.00	1,443,234.00
Universiteti "Kadri Zeka"	2017	930,214.00	316,339.00	50,000.00	10,000.00	250,000.00	1,556,553.00
Universiteti "Kadri Zeka"	2018	1,130,214.00	316,339.00	50,000.00	30,000.00	600,000.00	2,126,553.00
Universiteti "Kadri Zeka"	2019	1,297,642.55	316,339.00	50,000.00	100,000.00	600,000.00	2,363,981.55
Universiteti "Kadri Zeka"	2020	1,297,642.99	316,339.00	50,000.00	100,000.00	650,000.00	2,413,981.99

BUXHETI I UKZ-SË NDËR VITE





SIGURIMI I CILËSISË

Procesi i sigurimit të cilësisë ne Universiteti Kadri Zeka është përcaktuar me Statutin e Universitetit. Kjo nënkupton që të gjitha Njësitë Akadematike, Administrata, studentët, menaxhmenti i lartë i UKZ deri te Këshilli Drejtues, janë të kyçyr në procesin e sigurimit të cilësisë, që do të thotë përfshirjen e të gjithë të lartpërmendurve në proceset e sigurimit të cilësisë për Universitetin.

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, për të arritur objektivat kryesore strategjike ka arritur që në vitin 2018-të krijoj Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, e cila do të jetë vazhdimisht në monitorimin e cilësisë në mësim dhe zhvillimin e Institucionit.

Zyra për Shkencë, Zhvillim Akademik dhe Cilësi, koordinon punën në mbështetje të njërive akademike për procesin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përshijnë këto procese dhe po ashtu, koordinon punën e Zyrës me senatin e UKZ-së, Këshillin Drejtues, Njësitë Akadematike, Institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura etj.

MËSIMI ONLINE

Si pasojë e gjendjes së krijuar me pandeminë Covid-19, Universiteti “Kadri Zeka”, ka mundur zhvillimin e mësimit virtual duke përdorur platformat SMU, Google Meet, Google Classroom dhe Moodle.

Për dhjetë javë, sa kanë zgjatur ligjëratat onlajn, janë mbajtur 3600 orë mësimi, me njëqind mijë pjesëmarrës, me një mesatare prej 1500 kyçe ditore.

The slide is titled "Paraqitja tabelare dhe grafike e të dhënave kualitative". It features a hierarchical diagram showing "Të dhënat kualitative" branching into "Shpërndarja e frekuencave" (with a sub-label "Tabela përmbledhëse") and "Paraqitja grafike". The "Shpërndarja e frekuencave" section includes a table with columns x and f , and rows x_1, x_2, x_3, x_4 and f_1, f_2, f_3, f_4 , along with a summation symbol Σf . The "Paraqitja grafike" section includes icons for "Diagrami rrethor", "Bar diagramet", and "Diagrami i Paretos".

The screenshot shows a Skype video call interface. On the left, there is a sidebar with a search bar, "Meet Now" and "New Chat" buttons, and a list of recent chats. The main area displays a grid of video feeds for several participants, including a man in a red jacket in the foreground and others in the background.

The infographic, titled "MËSIMI ONLINE NË NUMRA", features the logo of the University of "Kadri Zeka" and lists the following statistics:

- Ligjëratat të mbajtura: 3,600
- Kyçe online: 100,000
- Mësimdhënës aktivë: 97
- 50 Ligjëratat në ditë
- 1,500 Kyçe ditore
- 3,000 Student aktivë

MËSIMI ONLINE

Si pasojë e gjendjes së krijuar me pandeminë Covid-19, Universiteti “Kadri Zeka”, ka mundësuar zhvillimin e mësimit virtual duke përdorur platformat SMU, Google Meet, Google Classroom dhe Moodle. Për dhjetë javë, sa kanë zgjatur ligjëratat onlajn, janë mbajtur 3600 orë mësimi, me njëqind mijë pjesëmarrës, me një mesatare prej 1500 kyçje ditore.



Paraqitja tabelare dhe grafike e të dhënave kualitative

Të dhënat kualitative

- Shpërndarja e frekuencave
Tabela përmbledhëse
- Paraqitja grafike
 - Diagrami rrethor
 - Bar diagramet
 - Diagrami i Paretos

x_i	f_i
x_1	f_1
x_2	f_2
x_3	f_3
x_4	f_4
Σ	Σf_i

Skype

Dikujtin Leka

Meet Now

RECENT CHATS

ONGOING CALL

E drejta Nderkombetare...

QA SMAHPC
Call ended - 8m 41s

Dardan Kocinj
It is in the name of Vice Rector

SMAHPC Project...
See you soon dear friends...

Teacher's Handbook
Hey, could you call me and...

Hadis Karatahi
Call started



VLERËSIMI I REKTORIT PROF. ASOC. DR. BAJRAM KOSUMI PËR MËSIMIN ONLINE

Të dashur studentë, profesorë dhe punëtorë të administratës,

Ju uroj për kalimin e suksesshëm të kësaj faze të pandemisë Covid 19. Universiteti Publik “Kadri Zeka” përfundoi procesin e ligjëratave onlajn me një sukses të jashtëzakonshëm. Për dhjetë javë, sa kanë zgjatur ligjëratat onlajn, janë mbajtur 3600 orë mësimi, me njëqind mijë pjesëmarrës, me një mesatare prej 1500 kyçje ditore.

Ligjëratat onlajn në fillim na u imponuan për shkak të pandemisë Covid 19, por në fund rezultoi me një ngritje cilësore shumë të madhe në UKZ dhe në universitetet publike në Kosovë.

Ne hymë në këtë proces pa përgatitje paraprake, pa trajnime, megjithatë na u desh vetëm një javë ta organizojmë sistemin onlajn dhe të startojmë me sukses në një fushë të panjohur për ne.

Rezultati i mësimit onlajn është përtej të gjitha pritjeve tona. Prezenca e studentëve në orët mësimore ka qenë më e madhe se ajo në klasa. Orët mësimore kanë zgjatur mesatarisht 41 minuta, më gjatë se orët në klasa. Ka shumë më pak orë të humbura se në mësimin në klasa. Profesorët janë përgatitur më me kujdes për orën mësimore.

Ky proces tregon se UKZ, por edhe universitetet e tjera publike në Kosovë, kanë një shkallë të lartë të përgatitjes akademike dhe teknologjike, si dhe të vullnetit për punë. Kjo dëshmon se universitetet publike kanë brenda vetes vlera të larta akademike dhe janë rruga e duhur për arsimin e lartë në Kosovë.

Ky proces është edhe një tregues se ne nuk duhet të heqim dorë nga mësimi onlajn, pavarësisht ndalesave për virusin Covid 19, apo ndonjë arsyeje tjetër. Ne e bëmë një ngritje cilësore në arsimin tonë të lartë dhe tash nuk duhet të zbrapsemi, por të gjejmë mënyra dhe moduse se ku mund e si mund ta përdorim mësimin onlajn edhe në të ardhmen.

Shpresoj që studentët do të përgatiten shumë mirë edhe për afatin e provimeve të qershorit dhe do ta përmbyllin me sukses këtë vit akademik.

Dëshiroj të falënderoj në radhë të parë studentët dhe Parlamentin Studentor të UKZ, të cilët u angazhuan me vullnet të madh në këtë proces.

E falënderoj stafin akademik, në radhë të parë dekanat e fakulteteve, të cilët nuk hezituan dhe nuk u zbrapsën para sfidave të cilat impononte kalimi nga mësimi klasik në mësimin onlajn dhe nuk humbën pothuajse asnjë orë mësimi.

E falënderoj edhe administratën e UKZ e cila qëndroi gjithë kohën pranë studentëve dhe stafit akademik në këtë proces të rëndësishëm. Jam krenar me këtë sukses të përbashkët!

Të dashur studentë, staf akademik dhe punëtorë të administratës, nuk duhet nënçmuar fakti se Covid 19 është ende prezent dhe ende godet. Ju ftoj të jeni pjesë e provimeve duke iu përmbajtur të gjitha rregullave të periudhës së pandemisë: mbani distancën dhe mos kontaktoni fizikisht me njëri tjetrin. Përshëndetni me dorë në zemër! Mbani maska gjatë provimit dhe mos u grumbulloni në grupe të mëdha.

Përshëndetni me dorë në zemër! Na priftë e mbara të gjithëve!

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi



Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi
Prorektor për mësim, kërkime
shkencore dhe Çështje të Studentëve



Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për bashkëpunim
Ndërkombëtar



Prof. Ass. Dr. Bajram Fejzullahu
Prorektor për Buxhet dhe Financa




Mr. Sc. Vaxhid Sadriu
Sekretar i Përgjithshëm

MENAXHMNETI I LARTË I UNIVERSITETIT

Universiteti Kadri Zeka ofron mundësi të shkëlqyera për mësim dhe përbëhet prej pesë njësive akademike me shtat programe studim Bachellor, dhe dy programe të studimit master, në të cilat studiojnë rreth 6 000 studentë.

STRUKTURA E UNIVERSITETIT





*Prof. Ass. Dr. Merxhan Avdyli
Dekan i Fakultetit të Edukimit*

FAKULTETI I EDUKIMIT

Fakulteti i Edukimit synon aftësimin e mësimeve dhe edukatorëve në frymë bashkëkohore, aftësimin për t'u përballë me një botë e cila vazhdimisht po ndryshon.

Këtu punohet në ngritjen e mësimeve dhe edukatorëve të rinj duke sjell përvoja të avancuara të vendeve perëndimore për aftësim profesional të mbështetur në praktikë dhe në krijimin e lidhjeve të natyrshme dhe të qëndrueshme midis fakultetit, shkollës dhe komunitetit arsimor.

Gjatë monitorimit të studentëve të Fakultetit të Edukimit rreth mësimit praktikë

Fakulteti i Edukimit përpos programeve aktuale të studimit në proces të akreditimit ka edhe programet në nivel master:

- ***Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe***
- ***Mësimdhënie dhe kurrikula.***



*Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu
Dekani i Fakultetit Juridik*

FAKULTETI JURIDIK

Fakulteti Juridik dallohet me programe studimi të modeleve bashkëkohorë si: e drejta kushtetuese dhe administrative, moduli penal, moduli civil, moduli nderkombetar dhe moduli finaciar, përmes të cilave i përgatisin me seriozitet studentët për tregun e punës.

Fakulteti Juridik në Universitetin “Kadri Zeka” mbetet një prej zgjedhjeve më të mira për të rinjtë e Komunës së Gjilanit dhe komunave tjera, si dhe studentët e Luginës së Preshevës dhe Maqedonisë Veriore. Ai konsiderohet si një nga degët kryesore në nivelet e studimit; Bachelor dhe Master që ofron programe studimi me modelet më të mira bashkëkohore bazuar në përvojat dhe metodat e universiteteve prestigjioze perëndimore. Fakulteti Juridik është lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë kosovare.

Përmes implementimit të plotë të sistemit evropian të transferimit të kredive, mundëson mobilitetin e studimeve në vend dhe jashtë vendit, me ç ‘rast sigurohet njohja e diplomës nga vendet evropiane të përfshira në procesin e Bolonjës.

FAKULTETI EKONOMIK



*Prof. Ass. Dr. Xhevat Sopi
Dekan i Fakultetit Ekonomik*

Fakultetit Ekonomik ka mision zgjerimin e horizonteve për menaxhim me përgjegjësi shoqërore të sfidave të biznesit dhe ekonomisë.

Fakulteti Ekonomik është i zgjedhur në biznes dhe ekonomi në vend dhe rajon për të bërë kërkime, për të mësuar dhe për të krijuar zgjidhje të zhvillimit të qëndrueshëm.

Programet e studimit në Fakultetin Ekonomik janë në përputhje me programet e dy universiteteve anëtare të Procesit të Bolonjës, përkatësisht Universitetin e Lublanës dhe Universitetin e Zagrebit.

Fakultetin Ekonomik ka këto programe studimi:

Menaxhment /BA, i cili krijon mundësi për studentët që të fitojnë njohuri dhe aftësi që të jenë në gjendje të zhvillojnë sektorin privat, të hulumtojnë nevojat e tregut në dimensionet e një ekonomie tregu të përparuar.

Banka, Financa dhe Kontabilitet /BA, që ofron njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike në fushën e Bankave, Financave dhe Kontabilitetit. Karakteri dallues i këtij programi qëndron në kombinimin e tri disiplinave të ndryshme, të cilat ofrojnë një bazë të shkëlqyeshme për të zhvilluar karrierë në industrinë e shërbimeve financiare, pastaj në fushën e kontabilitetit, por edhe në institucione publike.

Në proces të akreditimit Fakulteti Ekonomik, ka edhe këto programe të studimit:

Menaxhim dhe Ndërmarrësi / BA

Menaxhim dhe Ndërmarrësi / MA

Menaxhim Financiar / MA

Menaxhim i Marketingut dhe Komunikimit/MA

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE



*Prof. Assoc. Dr. Artan Dermaku
Dekan i Fakultetit të
Shkencave Kompjuterike*

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ka për mision ofrimin e ekspertëve të kompletuar në fushën e teknologjisë.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ofron njohuri themelore dhe të avancuara për sfidat teknologjike dhe softuerike në fushën e shkencave kompjuterike si dhe zbatimin e tyre në industrinë e IT-së dhe të zhvillimit të softuerëve për Web dizajn dhe Ekonomi.

Duke ditur se inxhinierët në kohët moderne duhet të jenë në gjendje të zgjidhin probleme dhe çështje gjithnjë e më komplekse, për të hartuar dhe për të zbatuar paketa softueri, për të hartuar dhe për të zbatuar zgjidhje në rrjete kompjuterike, apo për të përmirësuar dhe për të mirëmbajtur teknologjitë e informacionit, ato që do të ofrohen në këtë program Baçelor, do të mbulojnë teknikat të cilat do të rrisin produktivitetin në zhvillimin e programeve softuerike dhe të teknologjisë së informacioneve.

Për këtë qëllim, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, për nivelin Baçelor, ofron një bazë ndërdisiplinore, me studime të specializuara në dy fusha kryesore:

- *Inxhinieri Softuerike dhe web Design, si dhe*
- *Informatika për Ekonomi*

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike është në proces të akreditimit të programeve:

- *Sistemet dhe Teknologjia e Kontrollit/ BA*
- *Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale /MA*



*Prof. Assoc. Dr. Shprese Qamili
U. D. Dekane e Fakultetit të
Shkencave Aplikative*

FAKULTETI I SHKENCAVE APLIKATIVE

Fakultetit të Shkencave Aplikative ka mision edukimin aplikativ, duke i kushtuar kujdes vlerave njerëzore dhe qytetare, vlerave universale, si edhe përftimin e një kulture të gjerë akademike në mënyrën e gjykimit dhe reagimit ndaj situatave të shoqërisë bashkëkohore dhe dinamike.

Fakultetit të Shkencave Aplikative, me programin baçelor “Matematikë arsimore”, është nevojë e domosdoshme, i cili do të përmbushë një nga detyrimet e arsimit të lartë në Kosovë, e që është përgatitja e mësimeve të matematikës në një frymë të re të zhvillimeve të arsimit matematik të përcaktuara nga ICME, ERME, ATEE etj. Në vitet e ardhshme do të vazhdojmë me programe të tjera aplikative, të cilat kanë për bazë matematikën dhe zbatimin e saj në tregun e punës, sidomos në ekonominë dhe ndërmarrësin e rajonit dhe më gjerë.

Fakultetit të Shkencave Aplikative përgatit profesionistë të gatshëm për tregun e punës, dhe në shërbim të nevojave të shoqërisë së zhvilluar dhe prosperuese.

Universiteti “Kadri Zeka” me themelimin e FSHA dhe programit Matematikë Arsimore do të shfrytëzojë kapacitetet e saja dhe do të punojë me përkushtim dhe përgjegjësi që të përballë me sukses në përgatitjen e mësimeve të matematikës si lëndë kyçe në arsimin parauniversitar.